Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Nr/Br. 135/17
Data/Datum. 15.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 135/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje Tefik Sylejmani –Kryetar, Goran Milenkovič-Referues dhe Nuhi Paçarizi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 133/17, të parashtruar nga operatori ekonomik "Solution D" me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqësoj Driton Sanaja, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avancuar" me nr. të prokurimit 70030/17/008/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Spitali i Përgjithshëm Pejë, në seancën e dt. 09 qershor 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Solution D" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avancuar" me nr. të prokurimit 70030/17/008/121,të shpallur nga autoriteti kontraktues–Spitali i Përgjithshëm Pejë.

II. **ANULOHET**, vendimi i autoritetit kontraktues Spitalit të Përgjithshëm Pejë, njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avancuar" me nr. të prokurimit 70030/17/008/121, dhe lënda kthehet Rivlerësim .

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues **"Solution D"** me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

I. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Spitali i Përgjithshëm Pejë, më dt. 21 mars 2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. të prokurimit 70030/17/008/121.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 2 (dy) operator ekonomik, ku sipas komisionit të vlerësimit të ofertave 2 (dy) operatoret ekonomik i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më dt. 24 prill 2017, njofton operatorin ekonomik ankues me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. të prokurimit 70030/17/008/121

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 03 maj 2017, operatori ekonomik **"Solution D"** me seli në Prishtinë, në afatin e paparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm Pejë, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 52 dhe nenit 59 të LPP-së.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 18 maj 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me datën 29 maj 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport të ekspertizës sqaron se qëndroj pretendimet e operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar pajisje të cilat nuk janë ne përputhje me specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

Bazuar në atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm Pejë, përmes parashtresës me shkrim, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 29 maj 2017.

Operatori ekonomik ankues "Solution D" me seli Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 29 maj 2017.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me dt.09.06.2017 ku të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i AK,përfaqësuesi i OE ankues si dhe eksperti shqyrtues dhe teknik u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm , ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik i dt. 29 maj 2017, parashtresën e operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues, si dhe deklaratat e palëve gjatë seancës dëgjimore.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues "Solution D", z. Sanaja, deklaroj: "oferta që autoriteti kontraktues ka shpall fitues është në kundërshtim me specifikat teknike të kërkuara nga njësia kërkuese dhe kjo është në kundërshtim me nenin 59 dhe 52 të LPP-së.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në vazhdim të prezantimit theksoi: duke u bazuar ne ofertën e pranuar nga autoriteti kontraktues nuk hasim energji ultrasonike, të cekur nga operatori ekonomik fitues dhe të gjitha referencat e produkteve të ofertuar kanë të bëjnë me energji monopolare dhe bipolare të kombinuar në mes të katër porteve, por nuk kanë energji ultrasonike dhe produkti i kërkuar në dosjen e tenderit është totalisht më të kërkuarin që përkon me elektrokauter të thjeshtë të cilat veç i posedojnë spitalet.

Në kërkesën e njësisë instrumenti po ashtu duhet emitojnë energji ultrasonike dhe jo monopolare, vërehet në secilin produkt se përdorin energji monoplare. Aparati i ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar në treg kushton 8,500.00€.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues kërkojë nga paneli shqyrtues që pas shoshitjes së fakteve të dërgojnë lëndën në Rivlerësim dhe të kërkoj nga autoriteti kontraktues të evitoj shkeljet e evidentuara ligjore dhe të shpall "Solution D" fitues".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e autoritetit kontraktues Spitali Përgjithshëm Pejë, znj. Kelmendi deklaroj:" duke u bazuar ne ekspertizë që nuk është aparat ultrasonik këtë e mohojmë, pasi edhe ne përgjigje mund të shihni gjeneratorin ultrasonik. Ndërsa, sa i përket instrumentit, ka pas diçka diferencë ne dimensione, mirëpo sipas kirurgëve është dallim shumë i vogël dhe për kirurgji të

hapur nuk luan rol. I gjithë çmimi i këtyre instrumente nuk arrin çmimin e operatorit ekonomik tjetër ne radhë".

Eksperti teknik z. Kurtishaj, në gjatë seancës dëgjimore deklaroj:" me qenë se pretendimet ankimore kanë qenë kryesisht pretendime për specifika teknike, unë jam marrë më shumë me shqyrtimin e gjitha pretendimeve dhe sipas ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi bërë krahasimin me specifikat teknike të kërkuara në dosje të tenderit.

Lidhur me këtë për aparatin në fjalë kam hulumtuar edhe ne internet pikërisht për produktin e ofruar nga prodhuesi Boëa ARC 350, dhe nuk kam mund të vërtetoj se i njëjti aparat ofron energji ultrasonik e cila është kërkuar ne dosje. Prodhuesi Bowa kishte edhe pajisje tjera të cilat ofronin energji ultrasonike, mirëpo tipi ARC 350 nga hulumtimet që kam bërë nuk kam mund të vërtetoj se i njëjti ofron energji të tillë.

Në vazhdim të prezantimit eksperti teknik sqaroj: sa i përket instrumenteve të pajisjes që paraqiten si material shpenzues edhe vet autoriteti kontraktues ka pranuar se këto nuk korospodojnë me kërkesat e dosjes, përkundrazi ka ndryshime substancialisht të mëdha, p.sh. është kërkuar thikë laporaskopike me diametër 5mm, ndërsa është ofruar me diametër 10mm, d.m.th. edhe një herë më të madhe, po ashtu gjatësia nuk përputhet. Efektet e këtyre pajisjeve në procesin kirurgjik nuk mund ti potencoj, mirëpo janë të dhëna që nuk përputhen me ato të kërkuar në dosjen e tenderit. Kuptoj se janë pajise shpenzuese dhe mund të ketë diferenca, mirëpo diferenca 100% më të mëdha ose me të vogla për mendimin tim janë të papranueshme.

Ne fund të prezantimit eksperti teknik deklaroj, qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë".

Pretendimi i operatorit ekonomik ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit, respektivisht autoriteti kontraktues ka kërkuar instrument ultrasonic –thikë për laparaskopi me diametër 5 mm dhe gjatësi të instrumentit 23 cm, kurse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar instrument ultrasonic me diametër 10mm dhe gjatësi 20cm.

Po ashtu në dosjen e tenderit është kërkuar, thikë për kirurgji të hapur me diametër 5mm dhe gjatësi të instrumentit 36 cm, operatori ekonomik rekomanduar për kontratë ka ofruar instrument ultrasonik me diametër 10mm dhe gjatësi 36 cm. Në dosjen e tenderit është kërkuar, thikë për kirurgji të hapur me diametër 5mm dhe gjatësi të instrumentit 11 cm, operatori ekonomik rekomanduar për kontratë ka ofruar instrument ultrasonik me diametër 10mm dhe gjatësi 11cm, si dhe në dosjen e tenderit është kërkuar, thikë për kirurgji të hapur me madhësi të instrumentit 17 cm, operatori ekonomik rekomanduar për kontratë ka ofruar instrument ultrasonik me gjatësi 36cm.

Paneli shqyrtues bazuar ne nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, sqaron se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit si dhe specifikimin teknike, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka

plotësuar specifikimin teknike ashtu siç është kërkuara në Aneksin 1. Specifikimet teknike, të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues/teknik, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues, parashtresës së autoritetit kontraktues, deklaratës së përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues, deklaratës së përfaqësueses së autoritetit kontraktues, sqarimeve të dhëna nga ekspertit shqyrtues/teknik gjatës seancës dëgjimore, konstatoj se autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me gjenerator ligashure (thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. të prokurimit 70030/17/008/121, nuk ka respektuar nenin 56 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Tefik Sylejmani

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROCEDURËS PRISHTINË/A TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA